



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:179556

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06544584

C.nr.477/2020

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me Sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit Byroja Kosovare Sigurimit ( BKS) me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson G. A., zyrtare ligjore, kundër të paditurit B. M. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, për çështjen kontestuese rimbursim i dëmit, në seancen kryesore të mbajtur me date 19.11.2024, në praninë e të autorizuarës së paditësit dhe në praninë e të paditurit, ndërsa me datë 02.12.2024, bëri përpilimin e këtij :

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare Sigurimit ( BKS), me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri B. M. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, që paditësit të i'a paguaj shumën prej 22,987,00€, në emër të rimbursimit të dëmit, këtë shumë me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 19.11.2024, data e seancës kryesore , e deri në pagesën definitive.

II. DETYROHET pala paditëse, që kësaj gjykate, të ja paguaj shumën prej 100,00€, në emër të taksës për padi, e cila pagës do të bëhet në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit.

III. DETYROHET, i paditura që paditësit të i'a paguajë shumën si në piken 1 të këtij dispozitivit të aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 100,00€, të gjitha këto pagesa, do të paguhet në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnimin e ekzekutimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratoj në tërsi si të bazuar dhe ta detyroj të padituri që paditësit të i'a paguaj shumën prej 22,987,00€, në emër të rimbursimit të dëmit, të cilin ja ka shkaktuar tani paditëses, me fajin e tij, i cili fakt është vërtetuar nga provat të ilat gjenden në shkresat e lëndës.

E autorizuari e paditësit, ka deklaruar se i padituri më datën 08.06.2013, rreth orës 12:10, në rrugën e Varoshit në Ferizaj, ka shkaktuar aksident trafiku, me automjetin e markës "Golf", me targë të regjistrimit .... Deri tek aksidenti ka ardhur, kur automjeti "A", të cilin e drejtonte tani i padituri, duke mos e përshtatur shpejtësinë e godet këmbësorin G. K. , të cilit i shkakton lëndime të rënda trupore.

Po ashtu ka theksuar, i paditurit automjetin të cilin e ka drejtuar ("Golf", me targë të regjistrimit ...), ka qenë i pa siguruar- me policë të sigurimit të skaduar. Po ashtu ka theksuar, se ky aksident është shkaktuar me fajin ekskluziv të paditurit, ky fakt është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Xh. H. , nga Ferizaj, e cila është hartuar në procedurën penale, prandaj duke i pasur parasysh, këto fakte ta konstatuara, i ka propozuar Gjykatës që kërkesë padinë ta miratoj si të bazuar.

### Shpenzimet i ka kërkuar

I padituri, si në përgjigje në padi, ashtu në seancën përgatitore e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj në tërsi si të pa bazuar. Po ashtu e ka kontestuar edhe lartësinë e dëmit të cilin e ka kërkuar pala paditëse, sepse kjo shumë është shumë e lartë dhe nuk është në harmoni me lëndimet, të cilat i ka pësuar i dëmtuari.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje kontestimore të regresimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara, u lexuan: përgjigja në padi, transferim nga kontoja, aktgjykimi i datës 25.06.2019, aktgjykimi C.nr.459/13, dhe ekspertiza e ekspertit të komunikacionit, pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veq e veq dhe të gjithave bashkërisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë çështje kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 80.06.2013, është shkaktuar me fajin e të paditurit. Si rezultat i këtij aksidenti, paditësi të dëmtuarit G. K. , i'a ka paguar dëmin dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 22,987,00€.

a)Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 08.06.2013, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga thëniet në padi, deklarimeve në seanca gjyqësore, raporti i i aksidentit si dhe provave të tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky fakt nuk ishte kontestues në mesë të palëve ndërgjyqëse..

b)Se aksidenti, është shkaktuar me fajin e tani të paditurit B. M. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga thëniet në padi dhe theksimet e bëra në seancë dhe nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e në veçanti nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Xh. H. , i cili në ekspertizë e përpiluar në procedurë penale, ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet ekskluzive të paditurit, sepse i njëjti e ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes, duke lëvizur me shpejtësi prej rrethe 84.85 km/h, e cila është ma e madhe se ajo e lejuar për pjesën e rrugës (V-50km/h). Po ashtu është konstatuar, se i padituri me automjetin e markës „Golf ”, me targë të regjistrimit ..., e ka drejtuar të pa siguruar, e për të cilin rast nuk ekziston mbulesa e sigurimit.

c)Se paditësi e ka paguar dëmin, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga transferi bankar i datë 26.07.2019, dhe akt vlerësimi i dëmit, nga e cila vërtetohet se paditësi BKS, personit G. K. nga Ferizaj, i'a ka paguar dëmin në shumë prej 22,987.00 €.

Gjykata e detyroi të paditurin, që paditësit të j'a paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse aksidenti është shkaktuar me fajin e të paditurit, fakt i vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit, këtë dëm paditësi e ka paguar dhe i padituri ka detyrim që ta kompensoj, sepse paditësi e ka paguar zhdëmtimin pa qenë i detyruar ta paguaj, në bazë të kontratës së sigurimit dhe kushteve të sigurimit të auto përgjegjësise, e subrogon të dëmtuarin në relacion me të siguruarin apo gjdo person tjetër përgjegjës për dëmin deri në shumën e zhdëmtuar me kamatë dhe shpenzimet e procedurës.

Po ashtu kjo çështje është e rregulluar edhe me nenin 14 par.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga auto përgjegjësia, me të cilën dispozitë është paraparë e drejta e rimbursimit në procedurën e regresit ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si dispozita materiale abatoj nenet 939 të LMD-së, dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata i analizoj të gjitha theksimet e palës paditëse, e cila i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit, ta miratoj në tërësi si të bazuar, e të cilat theksime gjykata ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurit, sepse i njëjti e ka vozitur automjetin e markës “Golf”, pa policë të sigurimit, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e detyroi pala paditëse, qe kësaj gjykate, të ja paguaj shumën prej 100,00€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksën, me rastin e dorëzimit të padisë, ashtu siçë është paraparë me neni 253,4 të LPK-së

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të i'a kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 100,00 €, në emër të taksës për padi, të parapara me Udhëzimin Administrativ mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore nr.01/2017 si dhe konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithshme të procedurës kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.477/2020 prej datës 19.11.2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur, ka të drejtë të paraqes ankesë, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 02.12.2024

Paditësit 1x1,

Të paditurit 1x1